




BPrAL AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI

Java 5: FIRMAT

Alban Asllani, MSc, PhD Cand.
Universiteti AAB
alban.asllani@universitetiaab.com



Kompania / Firma

- Ekonomia e nje vendi përbëhet prej subjekteve të ndryshme ekonomike dhe institucioneve të tjera, të cilat në bashkëveprim njëra me tjetrën e formojnë ekonominë e vendit përkatës.
- Nga kjo del se të gjitha subjektet ekonomike brenda ekonomisë së vendit, të cilësdo pronë dhe lloj qofshin ato, veprojnë në kushte të përbashkëta të ekonomizimit.

Kuptimi i kompanisë / firmës

- Shikuar historikisht, ndërmarrja – firma, zanafillën e saj e ka nga procesi manufaktural i prodhimit, që bëhej në punëtori të vogla dhe me mjete primitive.
- Më vonë, me zhvillimin e shoqërisë kapitaliste, nga punëtorit e vogla, “lindën” fabrika-ndërmarrje të mëdha dhe në këtë mënyrë filloi faza e parë e zhvillimit të industrisë në kapitalizmin e hershëm dhe funksionimi i ndërmarrjeve si subjekte ekonomike.

Çka është ndërmarrja / kompania?

- Firma është një bazë që organizon dhe koordinon faktorët e prodhimit, punën, token, kapitalin dhe aftësitë sipërmarrëse, në procesin e prodhimit.
- Firmat veçonjë njëra me tjetrën në shumë mënyra por të gjitha ballafaqohen me këto probleme:
 - Çfarë malli apo shërbimi të prodhojnë dhe në çfarë sasive?
 - Çfarë teknologjie të përdoret për prodhim?
 - Ç'sasi faktorësh prodhimi të përdorin?
 - Çfarë strukture organizimi dhe drejtimi të zgjedhin? etj
- Gjithashtu, të gjitha firmat janë të detyruara të llogarisin tregues të tillë ekonomikë, si të ardhurat totale, kosto apo shpenzimet totale, fitimi, etj

Firmat dhe Tregjet

- Duke organizuar prodhimin, firma duhet të koordinojë aktivitetet të shumta të individëve. Ky koordinim mund të arrihet edhe përmes tregut.
- Tregu shërben si mekanizëm për të koordinuar planet e shitjes dhe të blerjes në mes agjenteve ekonomikë – individëve të ndryshëm.
- Duke blerë inpute dhe shërbime në shumë tregje individuale, kushdo mund të organizojë prodhimin e të mirave dhe shërbimeve të konsumon.
- Janë dy mënyra për të koordinuar aktivitetet ekonomike:
 - Koordinimi i firmës – individë paguan firmën për një mall apo shërbim
 - Koordinimi i tregut – individë shikojnë tregun dhe bene prodhimin apo shërbimin vet

Firmat dhe Tregjet

- Një individ mund të zgjedhë koordinimin e firmës përshkak se kjo mund të jetë metoda ekonomikisht më efiçente.
- Ka tre arsye pse firmat janë më efiçente se sa tregjet si koordinatore të aktiviteteve ekonomike:
 1. **Ulja e kosotove të transaksioneve** – sa here që shitet dhe blihet një mall ose shërbim kemi të bëjmë me një transaksion. Kostot e transaksioneve janë kosto që lidhen me gjetjen e firmave apo individëve të gatshëm që të ofrojnë mallin apo shërbimin, arrijtjen e marrëveshjes etj. Të gjitha këto dojnë kohë, energji dhe para.
 2. **Ekonomizimet e shkallës** – egzistojnë kur kosto e prodhimit të një njesie ulet, kur sasia e prodhimit rritet. Kjo është për arsye të ndryshme – si financiare, teknologjia, organizativi, kostonë fikse, etj.
 3. **Ekonomizimet e skudrave të prodhimit** – ndarja në ekipe të punës mund të sjellë efikasitet, të cilët specializohen në një linjë të punës dhe në këto mënyra sjellin efiçencë dhe rritje të produktivitetit.

Llojet e kompanive

- Në kohën bashkëkohore në vendet me ekonomi të tregut format më të njohura të ndërmarrjeve janë:
 - a. *ndërmarrjet e pavarura individuale* – FIRMAT INDIVIDUALE
 - b. *ortakëria (bashkëpronësia)* – FIRMAT ME ORTAKE
 - c. *shoqëritë aksionare* - KORPORATAT
 - d. *shoqëritë komanditore*

Ndërmarrjet e pavarura individuale

a) **Ndërmarrjet e pavarura individuale (firmat)** - Këto ndërmarrje i formojnë personat fizikë, të cilët njëherit janë dhe pronarë dhe menaxhojnë me firmën. Këto ndërmarrje zakonisht janë të vogla dhe zakonisht formohen në degë shërbyese (në tregti, hoteleri etj.), e shumë pakë në degë prodhuese.

- Karakteristikat kryesore të ndërmarrjeve të pavarura individuale janë:
 - pronari i firmës njëherit është edhe menaxher i firmës,
 - të punësuarit zakonisht janë anëtarët e familjes, çka nuk do të thotë se nuk punësohen edhe punëtorë jashtë rrethit familjar,
 - pronari drejtpërdrejt merr vendime afariste dhe komunikon me punëtorët, pra paraqet organin vendimmarrës,
 - pronari bënë vetëfinancimin e firmës, pasi që bankat afariste park i përkrahin me kredi afanizmin e këtyre ndërmarrjeve, për shkak të sigurisë dhe të mos mundësive për kthimin e kredive të marra,
 - pronari disponon me tërë fitimin dhe përgjigjet për detyrimet ndaj shtetit etj.
- Në kuadër të këtyre ndërmarrjeve dominon forma e mikro ndërmarrjeve (micro-enterprise).
- Problemi kryesor me të cilin ballafaqohen këto ndërmarrje është ai financiar.

Ortakëria

b) **Ortakëria (bashkëpronësia)** - Kjo formë e ndërmarrjeve formohet mbi bazën e dëshirës së dy ose më shumë firmave ose individeve. Ortakëria mund të jetë në dy forma kryesore:

- **shoqëria me përgjegjësi të pakufizuar (solidare).** Kjo shoqëri formohet me bashkimin e dy e më shumë personave, me qëllim që të kryejnë ndonjë veprimtari ekonomike të caktuar, prodhuese apo shërbyese. Anëtar i kësaj shoqërie mund të jetë çdo person fizik apo juridik, që me pëlqimin e tij pranon të jetë anëtar i kësaj shoqërie. Të gjithë anëtarët e shoqërisë janë të barabartë ndaj të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga afarizmi i kësaj shoqërie.
- **Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar.** Me rastin e participimit në kapitalin themelues, shumat e investitorëve (anëtarëve) nuk është e thënë të jenë të barabarta. Anëtarët përgjigjen për detyrimet e shoqërisë, vetëm me participimin e kapitalit të tyre në shoqëri, pra është i kufizuar.

Shoqëritë aksionare

c) **Shoqëritë aksionare (SHA).** SHA paraqesin formën organizative të ndërmarrjeve të mëdha, që formohen me bashkimin e shumë kapitaleve individuale në një kapital të përbashkët, që quhet **kapitali aksionar**. Vlera e kapitalit të përgjithshëm aksionar përbëhet nga shumta e aksioneve pjesëmarrëse në shoqërinë aksionare.

- Aksionarëve u jepen letra të veçanta me vlerë, që quhen aksione (fletaksione, me të cilat përcaktohet vlera nominale e aksionit dhe e drejta në pjesëmarrje të fitimit (dividentit, që i përgjigjet vlerës së kapitalit të tij participues.
- Për detyrimet e shoqërisë ndaj të besueshmëve përgjigjet shoqëria si tërësi, e jo veç e veç anëtarët e SHA.
- Me rastin e likuidimit të SHA, aksionarët e humbasin të drejtën që e kanë pasur në bazë të posedimit të aksioneve, mirëpo nuk obligohen të mbulojnë borxhet e shoqërisë nga pasuria e tyre jashtë kapitalit që e kanë participuar në SHA.
- Lartësia e vlerës nominale të kapitalit themelues të SHA paraqet shumën e kapitaleve individuale të aksionarëve, pa kurrfarë përkufizimi.
- Ndërkaq, shumën më të ulët të nevojshme për themelimin e shoqërisë aksionare e përcakton qeveria apo organi i autorizuar prej saj, siç mund të jetë banka popullore etj.

Shoqëritë aksionare - Kapitali aksionar

- SHA kanë përparësitë, në krahasim me ndërmarrjet individuale, e për t'i dalluar janë:
 - janë të përshtatshme për ndërmarrje të mëdha dhe ato publike ku nevojiten mjete të mëdha financiare, në të cilat kapitali individual është i pafuqishëm siç është rasti në: industrinë e metalurgjisë së zezë e me ngjyra, naftës, thëngjillit, energjetikës, PTT etj.
 - mundësojnë të perfeksionohet teknologjia më bashkëkohore dhe më të rritet prodhimtaria, cilësia dhe asortimenti dhe ndikon që shumë më lehtë ndërmarrja (SHA) të kyçet, jo vetëm në tregun e vendit, por edhe në atë botëror,
 - ofron shumë më tepër mundësi në marrjen e kredive, sepse ekziston mundësia shumë më e madhe e kthimit të kredisë, në krahasim me ndërmarrjet privat, për ç'arsye bankat mbështesin kreditimin e tyre.
- **Fitimi nga kapitali aksionar.** Avancimi i kapitaleve individuale në SHA bëhet me blerjen e aksioneve në tregun e bursës.
- Çdo aksioner ka edhe vlerën e vet që mund të jetë:
 - **nominale** (të përcaktuar me rastin e blerjes së fletaksioneve) dhe
 - **të tregut** (që përcaktohet në bazë të ofertës dhe të kërkesës në bursën e fletaksioneve).

Shoqerite aksionare - Fitimi i aksionarve

- Aksionarët pjesën e fitimit mund ta marrin në dy forma:
 - **nëpërmjet dividendës**, që do të thotë se poseduesit e aksioneve për çdo aksion që posedojnë marrin një shumë të caktuar nga ndërmarrja ku i kanë aksionet dhe
 - **nëpërmjet riinvestimit**, që do të thotë se shoqëria aksionare mund të mos ua shpërndajë fitimet aksionarëve, por atë pjesë ta riinvestojë në fondet kryesore, që në të ardhmen do t'u shtohen fitimet e mbajtësve të aksioneve. Ky fitim quhet **fitimi nga kapitali aksionar**.

Shoqëritë komanditore

- d) **Shoqëritë komanditore**. Këto janë shoqëri ku bashkohen dy e më shumë persona për të kryer ndonjë veprimtari ekonomike apo shërbyese.
- Formohen me marrëveshje shoqërore, kurse anëtarët e saj nuk kanë të drejta të barabarta
- Këto shoqëri paraqesin formën e ndërmarrjeve të përziera dhe përbehen prej dy lloj aksionarësh:
 - **Aksionarët e brendshëm (komplementarët)**, të cilët drejtpërdrejt dhe në mënyrë të pakufizuar udhëheqin dhe përgjigjen për detyrimet e kompanisë me tërë pasurinë e tyre dhe janë komplementar. Udhëheqja dhe përfaqësimi i kësaj shoqërie kryesisht bëhet nga aksionarët e brendshëm,
 - **Aksionarët e jashtëm (komanditorët)**, nuk marrin pjesë drejtpërdrejt dhe në udhëheqje dhe në afarizëm të ndërmarrjes, por mund të japin sugjerimi, propozime etj. Aksionarët e jashtëm gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në fitimin e shoqatës proporcionalisht me kapitalin e avancuar.

Rruget e rritjes së kapitalit nga firmat

- Firmat individuale dhe firmat me ortakë mund të shtojnë kapitalin e tyre:
 - Duke marrë hua nga miqtë
 - Duke marrë kredi nga banka
 - Duke perdore të gjithë pasurine që posedojnë
- Por këto firma janë të kufizuara për të zgjeruar prodhimtarinë e tyre sepse ka kufizime në metodat apo menyrat financiare për zgjerim.

Rruget e rritjes së kapitalit nga firmat

- Korporatat paraqesin një avantazh të theksuar në krahasim me grupet tjera të kompanive
- Korporata mund të zgjeron prodhimtarinë apo aktivitetin e saj ekonomik duke përdorur:
 - Burimet financiare të jashtme (shitja e obligacioneve, emitimi i aksioneve, marrja e kredive bankare)
 - Burimet financiare të mbrendshme (përdorimi i dividendes, fitimit, pasurisë egzistuese, pjesa e fitimit që nuk shpërndahet por futet prap në biznes, fondi i amortizimit)

Rruget e rritjes se kapitalit nga firmat

- Rruge tjera per zgjerimin e korporatave, krahas atyre te mbrendshme dhe te jashtme jane edhe:
 - Shkrirja – marrevshje mes dy apo me shume firmave per t'u bashkuar dhe per te krijuar nje firme te re me te madhe, me synim per te patur nje fitim me te madhe ne treg dhe per te rritur pjesemarrjen e tyre ne treg.
- Shkrirjet mund te realizohen ne disa forma:
 - Bashkimi apo shkrirja vertikale – firma qe prodhojne ne sektor te ndryshem nje produkt apo mall bashkohen
 - Bashkimi apo shkrirja horizontale – firma qe prodhojne te njeitin mall bashkohen
 - Bashkimi i firmave – konglomerate – firma qe jane te ndryshme dhe prodhojne mallra te ndryshem bashkohen

Literatura

- Mançellari, Hadëri (2007), "Hyrje në Ekonomi" Pegi Tiranë;
- Mankiw & Taylor (2010), "Ekonomiksi" UET-Press UK
- Ligjeratat dhe Ushtrimet